



# Rruga drejt Integritimit

Bashkimi Evropian  
dhe Ballkani Perëndimor





Nisur nga realiteti i një bashkëpunimi shumë të suksesshëm evropian, politik dhe rajonal, për më shumë se pesëdhjetë vjet, Bashkimi Evropian është shumë aktiv në ndihmën që i ofron vendeve të Ballkanit Perëndimor për forcimin e demokracisë dhe të bashkëpunimit më të ngushtë, ndërkohë që nxit një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në këtë rajon.

Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Kroacia, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia dhe Mali i Zi janë angazhuar ndaj konceptit të një stabiliteti të qëndrueshëm ekonomik, social dhe politik, që

garantohet përmes lidhjesh dhe marrëdhëniesh më të ngushta më Evropën.

Nisur nga ky realitet, Komisioni Evropian shpalli në Maj 1999, procesin e Stabilizim Asocimit, i cili përcakton parimet përmes të cilave vendet dhe popujt e rajonit përparojnë drejt integritimit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ndër prioritetet e përcaktuara tashmë përfshihen vendosja e një demokracie të mbështetur mbi shtetin ligjor, zhvillimi i ekonomisë së tregut dhe lufta kundër krimit të organizuar.

## Procesi i Stabilizim Asocimit

Ky proces ka për qëllim të pajisë vendet e Ballkanit Perëndimor me mjetet e domosdoshme për sigurimin e institucioneve demokratike të stabilizuara, sundimin e shtetit ligjor, sigurimin e ekonomive të hapura e të begata bazuar në praktikatat dhe standardet evropiane.

Tashmë janë krijuar lidhje të forta midis secilit vend të rajonit dhe Bashkimit Evropian dhe kjo është bërë e mundur përmes tri mekanizmash:

Tregtia, asistenca financiare dhe marrëdhëniet kontraktuale. Gjithashtu është nxitur edhe bashkëpunimi më i ngushtë mes vendeve të rajonit, sidomos nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe forcimit të bashkëpunimit në dogana dhe në lidhje me kthimin e refugjatëve.



# Balkani

## Drejt integritit evropian

Një shtyllë e rëndësishme e këtij procesi është nënshkrimi i Marrëveshjeve individuale të Stabilizimit Asocimit. Përmes tyre përcaktohen vlerat dhe parimet e përbashkëta që udhëheqin marrëdhëniet midis Bashkimit Evropian dhe secilit vend të rajonit. Elementet kryesore të marrëveshjeve janë:

- Nxitja e lëvizjes së lirë të mallrave
- Krijimi i institucioneve efikase
- Zhvillimi i ekonomisë së tregut
- Ulja e nivelit të krimit dhe korrupsionit
- Nxitja e reformës së arsimit të lartë
- Zhvillimi i demokracisë, të drejtat e njeriut, dhe shtypi i pavarur
- Përmirësimi i infrastrukturës së transportit në rajon



Në prill 2001, u nënshkrua Marrëveshja me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa në tetor 2001 me Kroacinë. Në janar 2003, u hapën negociatat për nënshkrimin e Marrëveshjes me Shqipërinë. Ndërkohë janë duke u diskutuar studimet e fizibilitetit, si një prelude i hapjes së negociatave me Bosnie-Hercegovinën dhe me Serbinë e Malin e Zi.

## Asistenca financiare

Që nga viti 1991, Bashkimi Evropian është donatori më i madh në këtë rajon, me thuajse 6 miliardë Euro të akorduara për asistencë. Bashkë me asistencën humanitare dhe bilaterale kjo shifër shkon deri në 20 miliardë Euro.

Në maj të vitit 2000, Komisioni Evropian bëri një propozim që thjeshtëzonte dhe përshpejtonte ndihmën e dhënë për të pesë vendet e rajonit, duke zëvendësuar të gjithë mekanizmat e mëparshëm të asistencës së Bashkimit Evropian (të tilla si OBNOVA dhe Phare) me një instrument të vetëm, të ri: Asistenca e Komunitetit për Rindërtim dhe Stabilizim (CARDS), që ka për qëllim mbështetjen e objektivave politike të Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e stabilitetit dhe zhvillimin në rajon.

Në bazë të rregullores së Këshillit për programin CARDS, për periudhën 2000-2006, aprovuar në Dhjetor 2000, këtij rajoni i janë akorduar më shumë se 5 miliardë Euro për asistencë, e cila përqëndrohet në rindërtim dhe infrastrukturë, nxitjen e demokracisë, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror si dhe në bashkëpunimin rajonal në këta pesë sektorë prioritarë:


- **Drejtesia dhe çështjet e brendëshme:** reforma në sistemin gjyqësor dhe në polici, emigrimi dhe azili, menaxhimi i integruar i kufijve, lufta kundër krimit të organizuar
- **Ndërtimi i kapaciteteve administrative:** reforma në administratën publike, tatimet dhe dogana
- **Zhvillimi ekonomik dhe social:** reforma ekonomike, kohezioni social, zhvillimi i infrastrukturës lokale, arsimit
- **Stabilizimi demokratik:** zhvillimi i shoqërisë civile, kthimi i refugjatëve, reforma në shtyp
- **Mjedisi dhe burimet natyrore:** forcimi, monitorimi dhe planifikimi i institucioneve



Dokumentet e Strategjisë së çdo vendi sigurojnë kuadrin brenda të cilit jepet asistenca për secilin prej tyre. Në të përcaktohen objektivat e bashkëpunimit, politikat reaguese dhe fushat prioritare, në bazë të vlerësimit të axhendës politike të vendit partner si dhe të situatës së tij politike dhe ekonomike.

Asistenca e CARDS menaxhohet në disa mënyra: Delegacionet e Komisionit Evropian në Shqipëri, Bosnie e Hercegovinë dhe Kroaci merren me menaxhimin e drejtpërdrejt të shumicës së projekteve dhe programeve nacionale. Për Serbinë e Malin e Zi dhe për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, asistenca jepet përmes një agjensie speciale, që është agjensie speciale, Agjensia Evropiane për Rindërtimin (EAR), me qendër në Selanik. Ndërsa selia qendrore e Bashkimit Evropian menaxhon të gjithë programet rajonale, programin Tempus për arsimin e lartë si dhe Zyrën e Asistencës Fiskale dhe për Doganat (CAFAO).

**Programet vjetore të CARDS, 2001-2003 (millionë Euro)**



Asistenca rajonale sigurohet në kuadrin e programit rajonal CARDS, përcaktuar në Dokumentin Rajonal të Strategjisë, në bazë të të cilit 10% e asistencës së përgjithshme të CARDS për periudhën 2002-2004 jepen për projektet e bashkëpunimit rajonal për menaxhimin e kufijve ndërkombëtarë, zhvillimin e infrastrukturës rajonale, ndërtimin e institucioneve dhe konsolidimin demokratik.

## Bashkëpunimi rajonal

Në Samitin e Zagrebit, mbajtur në Kroaci në nëntor të vitit 2000, krerët e politikës evropiane u shprehën se "Afrimi ... do të shkojë krah për krah këtij procesi për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal." Kjo gjë bazohet në besimin se bashkëpunimi më i thellë rajonal është rruga e duhur drejt stabilitetit dhe zhvillimit, jo vetëm nacional, po edhe rajonal, duke i shërbyer interesave të të gjithë vendeve pjesëmarrëse në këtë process. Bashkëpunimi më i ngushtë rajonal përfshin:

- Krijimin e një rrjeti marrëveshjes bilaterale të tregtisë së lirë
- Riintegrimin e rajonit në rrjetet e infrastrukturës
- Nxitjen e autoriteteve për të punuar së bashku në përgjigje të rreziqeve të përbashkëta që kërcënojnë sigurinë





## Tregtia

Në vitin 1990 Bashkimi Evropian krijoi me vendet e Ballkanit Perëndimor një zonë të tregtisë së lirë për të mbështetur reformën ekonomike dhe zhvillimin e sektorit privat. Në vitin 2000, për shumicën e mallrave industriale, dhe për një pjesë të prodhimeve bujqësore u vu regjimi i tregut të vetëm.

Tashmë Bashkimi Evropian është partneri më i madh tregtar i rajonit, më shumë së gjysma e eksporteve të të cilit shkojnë në tregun evropian. Sot, më shumë se 80% e mallrave të rajonit hyjnë në Evropë pa kufizime doganore.

## Ndërtimi i institucioneve dhe shteti ligjor

Ndër prioritetet e procesit të Stabilizim Asocimit, ndërtimi i institucioneve merr një rol parësor. Më 1 janar, 2003, rreth 600 oficerë policie dhe konsulentë civilë nga të pesëmbëdhjetë Shtetet Anëtare dhe tetëmbëdhjetë vendet partnere u rreshtuan nën një flamur të vetëm - atë të Misionit të Policisë së Bashkimit Evropian (EUPM) - duke nisur kështu të parin operacion civil të menaxhimit të krizave në kuadrin e Politikës Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes.



Ky mision vazhdon punën e suksesshme shtatë-vjeçare të UN International Police Task Force (IPTF) në Bosnie dhe Hercegovinë. Misioni monitoron punën e strukturave të policisë lokale dhe siguron trajnimin e nevojshëm për kontrollimin e aktiviteteve ilegale që vënë në rrezik funksionimin me sukses të shtetit, të tilla si krimi i organizuar, terrorizmi dhe trafikimi i qënieve njerëzve, drogave dhe armëve.

Tashmë është fare e qartë që, pavarësisht nga e kaluara e tij e turbulluar, rajoni ka përpara një të ardhme të sigurt e të begatë. E ardhmja është e lidhur me integrimin në Evropë. Kjo nënkupton krijimin e një situatë ku paqja, stabiliteti, prosperiteti dhe liria, të cilat mbizotërojnë prej 50 vjetësh brenda kufijve të Bashkimit Evropian, janë një realitet i padiskutueshëm edhe në Ballkanin Perëndimor.

Në çdo hartë të kontinentit rajoni paraqitet si një pjesë e padiskutueshme e Evropës. Popujt e Ballkanit Perëndimor asnjëherë nuk e kanë vënë në dyshim identitetin e tyre si evropianë që ndajnë vlera dhe parime të përbashkëta si dhe lidhje të thella kulturore dhe historike.

Bashkimi Evropian është angazhuar në këtë rajon me një investim afat-gjatë për paqen, stabilitetin dhe zhvillimin, në mbështetje të përpjekjeve të vazhdueshme të këtij rajoni për përballimin me sukses të sfidave politike, ekonomike dhe sociale të kohës që jetojmë.



## Kontakte

### Zyra e Bashkëpunimit të EuropeAid

Komisioni Evropian  
B-1049 Brussels  
Fax: (+32 2) 296 74 82  
[http://www.europa.eu.int/comm/europeaid/projects/cards/index\\_en.htm](http://www.europa.eu.int/comm/europeaid/projects/cards/index_en.htm)

### Drejtoria e Përgjithëshme e Marrëdhënieve me Jashtët

Komisioni Evropian  
B-1049 Brussels  
Fax: (+32 2) 299 21 98  
[http://europa.eu.int/comm/external\\_relations/see/index.htm](http://europa.eu.int/comm/external_relations/see/index.htm)

### Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri

Tirana, Rruga Donika Kastrioti - Villa n°42  
Tel: (+355) 42 28 320 / Fax: (+355) 42 30 752  
<http://www.delalb.cec.eu.int>

### Delegacioni i Komisionit Evropian në Bosnie-Hercegovinë

71000 Sarajevo, Dubrovacka 6  
Tel: (+387 33) 25 47 00 / Fax: (+387 33) 66 60 37  
<http://www.delbih.cec.eu.int>

### Delegacioni i Komisionit Evropian në Republikën e Kroacisë

10000 Zagreb, Masarykova 1  
Tel: (+385 1) 48 96 500 / Fax: (+385 1) 48 96 555  
<http://www.delhrv.cec.eu.int>

### Delegacioni i Komisionit Evropian në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

1000 Skopje, Marsal Tito 12  
Tel: (+389 2) 312 20 32 / Fax: (+389 2) 312 62 13  
<http://www.delmkd.cec.eu.int>

### Delegacioni i Komisionit Evropian në Serbi e Mal të Zi

11000 Belgrade, Krunska 73  
Tel: (+381 11) 308 32 00 / Fax: (+381 11) 308 32 01  
<http://www.delscg.cec.eu.int>

### Agjencia Evropiane për Rindërtim

**Selia Qëndrore**  
54626 Thessaloniki - Egnatia 4, Greece  
Tel: (+30 2310) 505 100 / Fax: (+30 2310) 505 172  
<http://www.ear.eu.int>

